FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për përdoruesin

ANTIHEMORROIDALE

Supozitorë

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë janë supozitorët Antihemorroidale dhe përse përdoren
2. Përpara se t'i përdorni supozitorët Antihemorroidale
3. Si t'i përdorni supozitorët Antihemorroidale
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si t'i ruani supozitorët Antihemorroidale
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË JANË SUPOZITORËT ANTIHEMORROIDALE DHE PËRSE PËRDOREN

Antihemorroidale - supozitorë është një bar anestezik lokal dhe antiseptik që përdoret në mjekimin e hemorroideve.
Përbërësit aktivë të këtij bari janë: efedrinë klorhidrat, lidokainë klorhidrat, bismuth subgalat, oksid zinku, balsam Peru dhe vaj ricini. Efedrina klorhidrat, në sajë të veprimit vazokonstriktor në membranat mukoze, zvogëlon kongjestionin. Lidokaina klorhidrat është një anestezik lokal dhe roli i saj në këtë bar është të qetësojë dhimbjet e hemorroideve. Bismuthi subgalat ka veti mbrojtëse të membranave mukoze, veti adstrigjente të dobëta dhe veti antiseptike të lehta. Oksidi i zinkut në këtë bar lehtëson irritimin lokal të shkaktuar nga hemorroidet. Balsami peruvian ka një veprim antiseptik të lehtë. Është përbërës i këtij bari, sepse qetëson simptomat e hemorroideve. Vaji i ricinit është i njohur për vetitë e tij laksative.

2. PËRPARA SE T'I PËRDORNI SUPOZITORËT ANTIHEMORROIDALE

Mos e përdorni këtë bar në qoftë se:

- vuani nga mbindjeshmëria ndaj lëndëve aktive apo ndaj ndonjërit prej përbërësve të këtij bari.

Marrja e barnave të tjera
Ky bar ndërvepron me barnat e grupit IMAO (inhibitorë të monoaminoksidazës), prandaj nuk duhet përdorur njëkohësisht me barnat e këtij grupi.
Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se keni ndonjë problem gjatë përdorimit të këtij bari.

Shtatzënia dhe ushqyerja me gji
Lidokaina kalon placentën dhe në qumështin e gjirit. Përdorimi në gratë shtatzëna dhe ato që ushqejnë fëmijët e tyre me gji të bëhet vetëm me këshillën dhe nën vëzhgimin e mjekut.

3. SI T'I PËRDORNI SUPOZITORËT ANTIHEMORROIDALE

Gjithmonë përdorini supozitorët sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Ky preparat është vetëm për përdorim rektal.

Doza:
1 supozitor duhet të aplikohet në rektum, mund të aplikohen deri në 2 supozitorë në ditë në varësi të këshillës së mjekut.
Nëse nuk ka përmirësim të gjendjes brenda 3 ditëve, konsultohuni menjëherë me mjekun tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, edhe supozitorët Antihemorroidale mund të shkaktojnë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.
Në raste të rralla shfaqen reaksione sensibilizimi, skuqje ose djegie të lëkurës.
Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj. Kur shfaqet ndonjë nga efektet anësore të mësipërme, mjekimi me këtë bar duhet ndërprerë dhe ju duhet të këshilloheni me mjekun ose me farmacistin tuaj.

5. SI T'I RUANI SUPOZITORËT ANTIHEMORROIDALE

Të mbahen larg fëmijëve!
Mos i përdorni supozitorët Antihemorroidale pas datës së skadencës e cila është e shënuar në paketim.
Të ruhen nën 25°C, në vend të thatë!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmbajnë supozitorët Antihemorroidale
Lëndët aktive janë: efedrinë klorhidrat, lidokainë klorhidrat, bismuth subgalat, oksid zinku, balsam Peru dhe vaj ricini.
Përbërës të tjerë: dioksid silici koloidal, yndyrna të ngurta.

Përmbajtja e paketimit: kuti me 10 supozitorë.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim dhe Prodhuesi:

PROFARMA sh.a.,
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Janar 2024.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.